



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.54

2005

29 qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.397, datë 9.6.2005	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar në projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korçë III”.....	1925
Vendim i KM nr.400, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën e Libonikut, qarku Korçë.....	1927
Vendim i KM nr.401, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Pogradecit, qarku Korçë.....	1927
Vendim i KM nr.402, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës së Voskopit, qarku Korçë.....	1928
Vendim i KM nr.403 ,datë 9.6.2005	Për caktimin e komisioneve, për përballimin e shpenzimeve të shqyrtimit dhe korrespondencës për dhënie dhe rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.....	1929
Vendim i KM nr.404, datë 9.6.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit	

	110/20 kV, Porto-Romano, Durrës.....	1932
Vendim i KM nr.405, datë 9.6.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës dhe rehabilitimi i kanalizimeve në shëtitoren “18 Shtatori”, në qytetin e Gjirokastrës.....	1933
Vendim i KM nr.406, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Çorovodës, qarku Berat.....	1935
Vendim i KM nr.407, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës së Golemit, qarku Fier.....	1935
Vendim i KM nr.408, datë 9.6.2005	Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncension të formës “BOO” të hidrocentraleve Stranik dhe Zall-Tore, në komunën Stravaj, Librazhd, si propozim i pakërkuar.....	1937
Vendim i KM nr.409, datë 9.6.2005	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2000 dhe 2001.....	1937
Vendim i KM nr.411, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Sarandës, qarku Vlorë.....	1940
Vendim i KM nr.412, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Bulqizës, qarku Dibër.....	1940
Vendim i KM nr.413, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Sukthit, qarku Durrës.....	1941
Vendim i KM nr.414, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë së Durrësit, qarku Durrës.....	1941
Vendim i KM nr.415, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë së Divjakës, qarku Fier.....	1942
Vendim i KM nr.417, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën e Qesaratit, qarku Gjirokastrë.....	1944
Vendim i KM nr.418, datë 9.6.2005	Për një shtesë në vendimin nr.412, datë 15.9.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisionit të posaçëm për dhënien e licencave profesionale”, të ndryshuar.....	1944
Vendim i KM nr.420, datë 9.6.2005	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 1999, në projektin “Shtesë fondesh për furnizimin me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut-Bistrica II-financim i përzier”.....	1945
Vendim i KM nr.421, datë 9.6.2005	Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “zyrat dhe ofiçina”, Sarandë, nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit Ministrisë së Transportit dhe të	

	Telekomunikacionit dhe të objektit “ish-parku i mallrave”, Sarandë, nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit”.....	1947
Vendim i KM nr.422, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën e Frakullës, qarku Fier.....	1948
Vendim i KM nr.424, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën e Çërravës, qarku Korçë.....	1949
Vendim i KM nr.425, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Elbasanit, qarku Elbasan.....	1949
Vendim i KM nr.426, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Gramshit, qarku Elbasan	1950
Vendim i KM nr.427, datë 9.6.2005	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës së Dushkut, qarku Fier.....	1952
Vendim i KM nr.428, datë 9.6.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Shijakut.....	1953

VENDIM
Nr.397, datë 9.6.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR NË PROJEKTIN “SHKARKIMI I
UJËRAVE TË ZEZA, KORÇË III”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar në projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korçë III”, me një fond grant 5 000 000 (pesë milionë) euro.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2003
“SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA, KORÇË III”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përmban bazën e kësaj Marrëveshjeje, *me qëllim* për të kontrubuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 25 nëntor 2003 në Tiranë,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Palët Kontraktuese, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlef të prej gjithsej deri 5 000 000 euro (pesë milionë euro) për projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korçë III”. U konstatua se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet në të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedurat e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftehet në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2011.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2 paragrafi 1

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 17.5.2005 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.400, datë 9.6.2005

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN E LIBONIKUT, QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës së Libonikut, qarku Korçë, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 642 (gjashtëqind e dyzet e dy).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.401, datë 9.6.2005

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË SË POGRADEÇIT, QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Pogradecit qarku Korçë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Pogradecit, miratuar me vendimin nr.364, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Pogradecit”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe bashkia e Pogradecit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
106-109	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi

4-5,7-12,16	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
158-170	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
173,175	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
1-3,6,13-15,17	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive sociale-kulturore e sportive.	Në pronësi
19-90	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
91-105,110, 113	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
115-116	Varrezat publike	Në pronësi
111	Troje dhe hapësira	Në përdorim
18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale.	Në pronësi
112	Toka jo produktive.	Në pronësi
114	Rrjeti i ndriçimit publik.	Në pronësi
119,121-125,127,138-143	Zyrat e partive politike, shoqatave ose zyra të tjera që ndodhen në ndërtesën e Bashkisë.	Në pronësi

VENDIM
Nr.402, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SË VOSKOPIT, QARKU KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës së Voskopit, qarku Korçë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës së Voskopit, miratuar me vendimin nr.511, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Voskop”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe komuna e Voskopit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3, 206-209	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
4-10	Prona që përdoren për kryerjen e veprimtarive sociale-kulturore.	Në pronësi
11	Monumente historike dhe kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
12-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
18-19,22-24	Rrugët e brendshme komunale dhe vendore	Në pronësi
41-47	Varreza publike	Në pronësi
48-55	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
56,58,59,61,63,64,66	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë produkteve).	Në përdorim
57,60,62,65,70,74,80,84,87	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë inproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
203-205	Kullota me interes vendor	Në pronësi

VENDIM**Nr.403, datë 9.6.2005**

PËR CAKTIMIN E KOMISIONEVE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË SHQYRTIMIT DHE KORRESPONDENCËS PËR DHËNIE DHE RINOVIM LICENCASH, AUTORIZIMESH DHE MIRATIMESH NGA AUTORITETI MBIKËQYRËS I SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve zbaton komisione për dhënie dhe rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit, shërbimeve aktuariale në sigurime dhe risigurime.

2. Komisionet caktohen për përballimin e shpenzimeve të përpunimit, zhvillimit të korrespondencës për verifikimin e saktësisë dhe plotësimit të dokumentacionit të paraqitur për marrje apo rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh.

3. Për marrje licence për ushtrim veprimtarie, si shoqëri sigurimi, zbatohen komisionet si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumën prej 20 000 (njëzet

mijë) lekësh;

b) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën angleze, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekësh;

c) Për dhënie licence për ushtrim veprimtarie sigurimi, çdo shoqëri e licencuar derdh, në çastin e marrjes së licencës, në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

4. Për marrje licence për zgjerim veprimtarie sigurimi të shoqërisë së sigurimit apo të degës së shoqërisë së huaj të sigurimit zbatohet komisioni prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, në çastin e marrjes së licencës.

5. Për marrje licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e agentit në sigurime apo dega e shoqërisë së huaj të agentit zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 2000 (dy mijë) lekësh;

b) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën angleze, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 3 000 (tre mijë) lekësh;

c) Për dhënie licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e agentit apo dega e shoqërisë së huaj të agentit, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh;

ç) Për rinovim licence të shoqërisë së agentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës së rinovuar, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

6. Për licencimin e agentit në sigurime zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënien e licencës së agentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh;

c) Për rinovim licence të agentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës së rinovuar, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 5000 (pesë mijë) lekësh.

7. Për marrje licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e brokerimit apo dega e shoqërisë së huaj të brokerimit zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 2000 (dy mijë) lekësh;

b) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën angleze, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 3000 (tre mijë) lekësh;

c) Për dhënie licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e brokerimit apo dega e shoqërisë së huaj të brokerimit, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh;

ç) Për dhënie autorizimi brokerit në sigurime, në çastin e marrjes së autorizimit, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh.

8. Për dhënie autorizimi aktuarit në sigurime zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënie autorizimi, në çastin e marrjes së autorizimit, derdhet në llogarinë bankare

të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

9. Për licencimin e vlerësuesit të dëmeve zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumën prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënie licence vlerësuesit të dëmeve, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

10. Për licencimin e konsulentëve në sigurime zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumën prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënie licence konsulentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës, derdhet, në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

11. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve zbaton komisione në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për dhënie miratimi, për:

a) ushtrim veprimtarie të shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) hapje zyre përfaqësimi të shoqërisë së huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) bashkim ose ndarje të shoqërisë së sigurimit;

ç) dhënie në sipërmarrje të disa funksioneve të shoqërisë së sigurimit.

12. Komisionet e parashikuara në këtë vendim janë të pakthyeshme.

13. Ngarkohet Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.404, datë 9.6.2005

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 KV, PORTO-ROMANO, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Porto-Romano, Durrës, sipas tabelës që i

bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH, sh.a.-së, Tiranë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet, të kompensohet në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4875 (katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) m² tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 8 287 500 (tetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e investimeve të KESH sh.a.-së, Tiranë zëri “Kosto lokale për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë, të jetë në ngarkim të KESH sh.a.-së, kërkuese për shpronësim.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit qershor 2005 dhe të përfundojë brenda muajit korrik 2005.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni kanë filluar në mars 2005 dhe do të përfundojnë në maj 2006.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH sh.a. Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË SHRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË
NËNSTACIONIT 110/20 KV NË ZONËN E PORTO-ROMANOS, DURRËS”

Rrethi: Durrës

Komuna: Spitallë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore arë.

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë
1	Feti	Jusuf	Istrefi	Tokë bujqësore	8517	98/6	4875	1700	8 287 500
	Totali								8 287 500

Sqarime: Shpenzime procedurale: 1. Publikime 105 000 (njëqind e pesë mijë) lekë.

2. Shpërblim i anëtarëve të komisionit 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Vlefë totale e shpronësimit = 8 287 500 + 130 000 + 8 417 500 lekë.

VENDIM
Nr.405, datë 9.6.2005

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS DHE REHABILITIMI I KANALIZIMEVE NË SHËTITOREN “18 SHTATORI”, NË QYTETIN E GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës dhe rehabilitimi i kanalizimeve në shëtitoren “18 Shtatori”, në qytetin e Gjirokastrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Gjirokastrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 976 (nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m², vlerësuar në vlerën e përgjithshme prej 10 873 539 (dhjetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën prej 320 000 (treqind e njëzet mijë) lekësh, të përballohet nga bashkia e Gjirokastrës, e cila do të kryejë pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të mbarojë në muajin gusht 2005.

7. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Gjirokastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS DHE REHABILITIMI I KANALIZIMEVE NË SHËTITOREN “18 SHTATORI” NË QYTETIN E GJIROKASTRËS

1. Për truallin

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
1.	Reiz Fiqo Ruca	350 m ²	3500	1 225 00.
2.	Reiz Fiqo Ruca	50 m ²	3500	175 000

3.	Bashkëpronarët Spartak Hoxha Gjergj Hoxha Leonard Hoxha Etleva Hoxha Qerim Hoxha Sabihe Hoxha Ylber Hoxha Kreshnik Hoxha Elsa Mezini Aurel Hoxha Nedin Hoxha Bajram Hoxha Afërdita Sinani Kastriot Hoxha Fatmira Hoxha Flutura Shaba	280.9 m ²	4000	1 123 600
4.	Tatjana Agim Shabani	72 m ²	5952	428 544
5.	Ibrahim Kasem Buzheri	143.1 m ²	4000	572 400
6.	Jani Ruxho	4 m ²	3500	14 000

2. Për objektin

Nr.	Emri	Emërtimi	Vlera në lekë
1.	Tatjana Agim Shabani	Lokal sip 72 m ²	6 426 588
2.	Ibrahim Kasem Buzheri	Shatërvan	807 811
3.	Jani Ruxho	Lokal 4 m ²	100 596

Vlera totale e këtij shpronësimi është 10 873 539 (dhjetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre e mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekë.

VENDIM **Nr.406, datë 9.6.2005**

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË E ÇOROVODËS, QARKU BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë të Çorovodës, qarku Berat, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 970 (nëntëqind e shtatëdhjetë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.407, datë 9.6.2005

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS SË GOLEMIT, QARKU FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës së Golemit, qarku Fier, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës së Golemit, miratuar me vendimin nr.512, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Golem”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe komuna e Golemit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-2	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
3-7	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive sociale-kulturore e sportive.	Në pronësi

8-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
17-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
23-68,84-86,204-206	Troje dhe hapësira	Në përdorim
69-79	Varrezat publike	Në pronësi
82-83,87-103	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
106-129	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
134,163,169,182	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. (tokë inproduktive, kanale të treta)	Në pronësi
136-153	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë produktive).	Në përdorim
183-193	Ujësjetellës të veçantë të fshatrave Kanalizime të veçanta të fshatrave	Në pronësi
194-203,207,209-210	Rrugë vendore të brendshme dhe komunale	Në pronësi
240-241	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi
82,83,84,85,86,107	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes kombëtare.	Në pronësi

VENDIM
Nr.408, datë 9.6.2005

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION TË FOR MËS
“BOO” TË HIDROCENTRALEVE STRANIK DHE ZALL-TORE, NË KOMUNËN
STRAVAJ, LIBRAZH, SI PROPOZIM I PAKËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOO” (ndërtim, pronësi, shfrytëzim) të hidrocentraleve Stranik dhe Zall-Tore, në komunën Stravaj, Librazhd si propozim i pakërkuar, nga shoqëria “Hidroinvest” sh.p.k. Çarshovë, Përmet.

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes koncesionare.

3. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.409, datë 9.6.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2000 DHE 2001**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimi i marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2000 dhe 2001 në projektin “Linjë transmetimi 400 kV, Shqipëri-Mali i Zi”, me një hua 3.579 milionë euro dhe një grant 5.31 milionë euro.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2000-2001

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje, *me qëllim* për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datave 23 qershor 2000 dhe 5 dhjetor 2001, u morën vesh si vijon:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Palët Kontraktuese, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, shumat e më poshtme:

1. Një hua me vleftë prej gjithsej deri në 3 579 043,17 euro (me fjalë: tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e tre euro e shtatëmbëdhjetë centë), si dhe

2. një shumë financimi me vleftë prej gjithsej deri në 5 317 435, 56 euro (me fjalë: pesë milionë treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë euro e pesëdhjetë e gjashtë centë) për projektin “Linja përcjellëse elektrike 400 kV nga Shqipëria për në Malin e Zi”. U konstatua se projekti në fjalë vlen për t’u mbështetur.

2) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në parim është e gatshme që, përveç shumave të përmendura në paragrafin 1 në kuadër të dispozitave brendashtetërore që janë në fuqi

në Republikën Federale Gjermane dhe pasi të jenë përmbushur kushtet për mbulim, të marrë përsipër një garanci prej deri 12 000 000 euro (me fjalë: dymbëdhjetë milionë euro) për të krijuar mundësi për kredi të palidhura me financim të përzier të bashkëpunimit financiar nëpërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau për projektin e përmendur në paragrafin 1.

3) Po të merren vesh Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose infrastrukturës sociale ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave ose si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

4) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financiare për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqërore për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

5) Shuma e financimit për masa përgatitore dhe shoqërore sipas paragrafëve 3 dhe 4 do të kthehen në hua, kur ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në neni 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedurat e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve respektivë të marrësve të shumës së financimit, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për hua dhe për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën e financimit, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2008, ndërsa për shumën e huasë afati mbaron më datë 31 dhjetor 2009.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau lidhur me pretendimet eventuale të kthimit, të cilat mund të ngrihen në bazë të kontratave të financimit, që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë dhe nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të

ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, në rastet e duhura, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 17.5.2005 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.411, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË E SARANDËS, QARKU VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Sarandës, qarku Vlorë, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 368 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.412, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË E BULQIZËS, QARKU DIBËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në

juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Bulqizës, qarku Dibër, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 380 (treqind e tetëdhjetë).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.413, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË E SUKTHIT, QARKU DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Sukthit, qarku Durrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 545 (pesëqind e dyzet e pesë).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.414, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË I TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, BASHKISË SË DURRËSIT, QARKU DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë së Durrësit, qarku Durrës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Durrësit, miratuar me vendimin nr.648, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë e Durrësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe bashkia e Durrësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
25,55,56,739	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative.	Në pronësi
118,121,125,126,128,129,130	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor.	Në pronësi
137-175	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
176-179,180-212,213-215	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
1803,1807, 1809-1816	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
127,131,132,133,134,135,136,174	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
733-736	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale.	Në pronësi
216-732	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
737-806, 814-821, 828-869 870-1059	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
822-827	Varrezat publike	Në pronësi
1060-1253	Troje dhe hapësira	Në përdorim
1286, 1289, 1293-1295, 1306, 1307, 1308, 1310-1369, 1374-1377, 1378-1398	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta dhe tokë inproduktive dhe objekte të ish- NB).	Në pronësi
1290-1292, 1301-1305, 1370-1373	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë produktive).	Në përdorim

VENDIM

Nr.415, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË I TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË

PËRDORIM, BASHKISË SË DIVJAKËS, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë së Divjakës, qarku Fier, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Divjakës, miratuar me vendimin nr.556, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Divjakës”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe bashkia e Divjakës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
25, 26, 36	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
14	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor.	Në pronësi
18-24	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
28-32	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
13, 15, 16, 17	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
662,663,664,669,670,673, 674,675,676,677,679,680,684, 685,688,689,690,691,692, 695,696,697,698,699,700, 701,702,705,706,709,710 711	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
455,466,480,485,496,501, 503,506,508,512.665,666, 667,671,672,682,683,686, 687,693,694,703,704,707,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi

708,713,714,715		
4-13	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
55-91,597-625	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbimet publike	Në pronësi
40-54	Varrezat publike	Në pronësi
92-345	Troje dhe hapësira	Në përdorim
558,559,560,561,562,563,564,565,566,567,568,569,570,571,572,573,574,575,576,577,578,579,580,581	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe vendstrehim i nëndheshëm.	Në pronësi

VENDIM
Nr.417, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN E QESARATIT, QARKU GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës së Qesaratit, qarku Gjirokastrë, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 353 (treqind e pesëdhjetë e tre).

2. Ndryshimet që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.418, datë 9.6.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.412, DATË 15.9.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.412, datë 15.9.1992 të Këshillit të Ministrave, të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dhënia e licencave profesionale në fushën e shërbimeve publike, me karakter vendor, për:

- shërbimin për administrimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe inerte;
- shërbimin për administrimin e parqeve, të lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike;
- shërbimin për administrimin e varrezave publike dhe të dëshmorëve;
- shërbimin publik të varrimit;
- shërbimin e dekorit,

të bëhet nga komisionet e posaçme për dhënien e licencave profesionale, të ngritura pranë bashkive dhe komunave. Kriteret e procedurat e dhënies së këtyre licencave e të funksionimit të komisioneve përkatëse miratohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe bashkitë e komunat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.420, datë 9.6.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 1999, NË PROJEKTIN “SHITESË
FONDESH PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NË SHQIPËRINË E
JUGUT-BISTRICA II-FINANCIM I PËRZIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 1999, në projektin “Shtesë fondesh për furnizimin me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut-Bistrica II-financim i përzier”, me një hua 1.79 milionë euro.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 1999

“SHITESË FONDESH PËR FURNIZIMIN E SHQIPËRISË JUGORE ME ENERGJI ELEKTRIKE - BISTRICA II, FINANCIM I PËRZIER”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 2 dhjetor 2004 në Tiranë,

u morën vesh si vijon.

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Palët Kontraktuese, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Frankfurt mbi Majn, një hua me vlef të prej gjithsej 1 789 521,59 EUR (me fjalë: një milionë shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e një euro dhe pesëdhjetë e nëntë centë) për projektin “Shtesë fondesh për furnizimin e Shqipërisë jugore me energji elektrike - Bistrica II - Financim i përzier”. U konstatua se projekti vlen për t'u mbështetur.

2) Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1) Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftehet, në rast se kontrata përkatëse për hua nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2007.

2) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 17.5.2005 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.421, datë 9.6.2005

PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT “ZYRAT DHE OFIÇINA”, SARANDË, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT DHE TË OBJEKTIT “ISH-PARKU I MALLRAVE”, SARANDË, NGA MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.226, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti “Zyrat dhe ofiçina” të Drejtorisë së Ujërave, Sarandë, me sipërfaqe 6000 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, t’i kalojë në përgjegjësi

administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, dega Sarandë.

2. Objekti “Ish-parku i mallrave”, Sarandë, me sipërfaqe 1993,4 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, për nevojat e bordit të kullimit, Sarandë.

3. Në vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, në listën bashkëlidhur, në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, në bashkinë e Sarandës, në objektin me nr.1, “QKT-Sarandë”, të dhënat e kolonave 6 e 7, përkatësisht “Ish-PAM, Sarandë”, dhe “1993,4” zëvendësohen me “Zyrat dhe ofiçina e Drejtorisë së Ujërave, Sarandë” dhe “6000”.

4. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.422, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN E FRAKULLËS, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të komunës së Frakullës, qarku Fier, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 50 (pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë).

2. Ndryshimet që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.424, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN E ÇËRRAVËS, QARKU KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës së Çërravës, qarku Korçë, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 33 (tridhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër).

2. Ndryshimet, që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.425, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË SË ELBASANIT, QARKU ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Elbasanit, qarku Elbasan, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Elbasanit, miratuar me vendimin nr.154, datë 11.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5,118,451-452	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi

21-23;26	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative.	Në pronësi
28,29	Prona që përdoren nga partitë politike.	Në pronësi
51-112	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
405-407,409-420	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
238-247 265,266,267,268,269,456	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
248-259,263,264,271	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor.	Në pronësi
272	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale.	Në pronësi
280-399	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
400-402,490-617 641-656	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
486	Varreza publike	Në pronësi
618-640	Troje dhe hapësira	Në përdorim
124-237	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë e të ushqimit.	Në pronësi

VENDIM
Nr.426, datë 9.6.2005

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË SË GRAMSHIT, QARKU ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Gramshit, qarku Elbasan, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Gramshit, miratuar me vendimin nr.327, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Gramshit”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe bashkia e Gramshit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
293-297,348-350,393	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
21	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
3-14,16,17	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
26,27,31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
22,23,24,25,18,19,20	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
298-309	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
249,258,259,260,261,262,263,264-287,339,399-462,463-465	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
250,251,252,253	Varreza publike	Në pronësi
44-248,254-257	Troje dhe hapësira	Në përdorim
40-43	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale.	Në pronësi
482	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi
337,351	Zyra të partive politike, shoqatave ose zyra të tjera	Në pronësi
394,395,396,397	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes kombëtare.	Në pronësi

VENDIM
Nr.427, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SË DUSHKUT, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës së Dushkut, qarku Fier, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës së Dushkut, miratuar me vendimin nr.513, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dushk”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe komuna e Dushkut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11-19	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
20,23,24,26,27,28,29,30,31,32,33,34	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
21,22,25,51,61,67,71,78,83	Prona që përdoren në ushtrimin e funksioneve të ujitjes dhe kullimit (kanale të treta) PF.	Në pronësi
88-92	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
94	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën sociale.	Në pronësi
95-126	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
127-135,144 136-137,140	Troje dhe hapësira Rrugë të brendshme komunale dhe vendore	Në përdorim Në pronësi
141-143	Ujësjellës dhe sisteme kanalizimesh të veçanta të fshatrave	Në pronësi
145	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi
153,154,156	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
155	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
157-162	Varreza publike	Në pronësi

VENDIM

Nr.428, datë 9.6.2005

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I VARREZAVE
PUBLIKE NË QYTETIN E SHIJAKUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private (tokë arë), që preket nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Shijakut.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shijakut.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompesohet në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi, për sipërfaqen 4 950 (katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) m² tokë arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 4 950 000 (katër milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekësh dhe të përballohet nga bashkia e Shijakut.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit korrik 2005.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Shijakut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE
TË QYTETIT TË SHIJAKUT**

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë arë m/2	Njësia lekë m/2	Vlera lekë
1.	Asllan Ibrahim Keçi	4950	1000	4 950 000
	Totali			4 950 000

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 29.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë